



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË

Tiranë, më 24.05.2024

NJOFTIM

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË KONKURIMIT
PËR

EMERIMIN NË POZICIONIN E PUNËS NJË VEND

SHOFER

Bazuar në Ligjin Nr 97/2016 “ Për Organizimin dhe funksionimi e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë , si dhe mbi bazën e “ Strukturës organike të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë , me qëllim plotësimin e vendit vakant në zbatim të strukturës së Institucionit, në përmbushje të organikës Nr. 09 datë 30.01.2024, të Prokurorit të Përgjithshëm, për Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë .

1. Kërkohe të punësohet 1(një) punonjës me emertese shofer, në Prokurorinë Pranë Gjykatës së shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me adrese ,Rr. Haxhi.H. Dalliu Nr 97 Tiranë..

N J O F T O N

1.Fillimin e Procedurës së konkurimit të hapur të kandidateve për një pozicion me emertese shofer, në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë .

2. Referuar neneve 74,75,76 të Ligjit nr 97/2016 “ Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë “, kandidatet e interesuar

për konkurim, përveç kushteve të përgjithshme për tu pranuar në punë, duhet të plotesojnë dhe kriteret të veçanta.

1. Kandidatët për një pozicion të lire të punës “ shofer“ duhet të paraqesin kërkesën së bashku me dokumentacionin e mëposhtëm që kanë plotësuar kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të mëposhtme:

- Kushte të përgjithshme

- a) të jetë shtetas shqiptar
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar
- c) të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur
- d) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje si dhe të mos jetë nën hetim;
- f) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil apo administrata shtetërore që nuk është shuar sipas këtij ligji;
- g) të ketë përfunduar arsimin e mesem ose të lartë
- h) të ketë experience pune si shofer
- i) Të ketë aftësi për të krijuar marrëdhënie pune efektive me stafin e prokurorisë.
- j) Të ketë aftësi komunikuese dhe punë në grup.
- k) Të ruajë sekretin hetimor.
- l) Të ketë sjellje etike dhe morale

- Kushtet e veçanta :

- a) Kërkesë për punësim,
- b) Fotokopje e letërnjoftimit/kartës së identitetit/pasaportë.
- c) CV (Jetëshkrim) të detajuar së bashku me një foto.
- d) Diplomë e shkollës së Mesme ose të lartë e fotokopjuar dhe e noterizuar
- e) Një kopje e noterizuar e Lejës së Drejtimit për automjet
- f) Ekperience pune si shofer
- g) Vërtetim përmbartimi gjyqësor
- h) Vërtetim për gjendjen gjyqësore (Dëshmi penaliteti).
- i) Vërtetim nga Gjykata .
- j) Vërtetim nga Prokuroria
- k) Fotokopje të librezës së punës ose vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore që të provojë punësimin e mëparshëm ose vërtetim nga qendra e mëparshme e punës, ku të evidentohet pozicioni i punës dhe kohëzgjatja.

- l) Vërtetim i njësish administrative
- m) Vërtetim mjekësor për gjëndjen shëndetësore.
- n) Vërtetim që nuk ka marrë masa disiplinore

Kërkesa së bashku me dokumentacionin e kandidatit, të paraqitet nga dt.24.05.2024 ora 8.00 deri në datë 10.06.2024 ora 16.00, në K/sekretarinë e Prokurorisë Pranë gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë , Rr “ Haxhi.H. Dalli ” Nr 97 Tiranë .

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLË SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TIRANË**